



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALIQ  
SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Maliq, më 20.05.2024

**Relacion**

Mbi projektin ***“Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar”*** me financim të përbashkët nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Maliq

Në mbështetje të ligjit nr . 139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e shqipërisë”, dhe vkm-së nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, Bashkia Maliq në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Nis shërbimin në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar .

Ky shërbim ka si qëllim kryesor ngritjen e nje shërbimi për te moshuarit dhe familjeve në nevojë ku prinderit jane me AK , me qellim zgjerimin e hartës së shërbimeve, në njesite të cilat nuk kane sherbime ne zone dhe kane nje distance te larget nga ofruesit e sherbimeve ne qender dhe eshte i lidhur me permbushjen e Prioritetit strategjik 1dhe 4 si dhe Objektivit specific 1 dhe 2 te Planit Social të bashkisë Maliq.

Përfitues të këtij shërbimi janë banorë të moshuar të vetmuar në Bashkinë Maliq; familjet e personave me aftësi të kufizuar , persona me aftësi të kufizuar ; familjet dhe qytetarët në nevojë. punonjësve sociale. rrethi i gjerë familjar i familjeve target; punonjës të strukturave të posaçmetë shërbimeve sociale pranë bashkisë; punonjësit e shërbimit social shtetëror; punonjësit e njësive të vlerësimit të nevojave dhe referimit në çdo njësi administrative; profesionistë të tjerë të shërbimeve psikosociale të sitemit shëndetësor dhe arsimor në nivel vendor.

Aktivitetet kryesore të këtij shërbimi do të jenë

1. *Mbështetje psiko sociale përmes ofrimit të informacionit, këshillimit dhe advokimit.*
2. *Mbeshtetje higjeno-sanitare ne familje*
3. *Sigurimi i aksesit në rrjetet e shërbimeve në komunitet*
4. *Mbështje për aftësim profesional, punësim per familjet me persona me AK*
5. *Ofrimi i kujdesit afatshkurtër në shtëpi.*
6. *Identifikim dhe referim për mbështetje, i ndihmesit personal te personave ne nevoje*
7. *Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese për gjithpërfshirjen e personave me AK dhe per moshen e trete*
8. *Trajnime të stafit mbi shërbimin në familje*


Shuma e deleguar nga Fondi Social për vitin 2024 është 3,126,776 lekë

Ky shërbim do të përfshijë kryesisht të moshuar të vetmuar në nevojë për mbrojtje duke ju ofruar atyre kujdes higjienosanitar në banesë, kujdes afatshkurter për nevoja të ndryshme si ilaçe, mbështetje në natyrë me paketa veshje dhe elektro shtëpiake sipas rastit dhe problematikave të tij, informim dhe orientim drejt shërbimeve të tjera të ofruara nga aktorë të ndryshëm lokalë, aktivitete të ndryshme etj.

Gjithashtu një vëmendje do ti jepet edhe familjeve që kanë prindër me aftësi të kufizuar në ndihma higjienosanitare dhe ushqimore, asistencë në menaxhimin e të ardhurave të familjes dhe orientim dhe këshillim mbi arsimin e fëmijëve apo bashkepunimeve me zyrën e punës për punësimin e personave me AK.

Ky shërbim do të jetë një pikë kthese në ofrimin e shërbimeve duke i orientuar ato në ambientin familjar duke parandaluar edhe institucionalizimin e përfituesëve të këtij program.

(Emër Mbiemër)  
Përgj i Sekt. Sh.të kujdesit Shoqëror E.Petriri

Nënshkrimi  


Data  
Dt 20.05.2024

**KRYETARI I BASHKISË**  
**Gëzim Topçiu**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALIQ  
SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Maliq, më 14.07.2023

**Projekt-Vendim**

Mbi përdorimin e fondit për projektin **“Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar”** me financim të përbashkët nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Maliq, viti i dytë.

Në mbështetje të ligjit nr. 139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, dhe vkm-së nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, marrëveshjes së Bashkia Maliq me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale datë 04.05.2023 dhe shkresës nr. 416/18 prot, datë 23.01.2024 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për celjen e fondit prej 3,126,776 lekë për vitin 2024.

**Kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Maliq:**

1. Të miratojë përdorimin e fondit të deleguar nga Fondi Social i MSHMS me vlerë totale lekë (për vitin 2024) për zbatimin e projektit **“Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar”**, të detajuar si më poshtë ;
  - 1.1 Miratim fondi me vlerë lekë për paga dhe sigurime të punonjësve që do të ofrojnë këtë shërbim sipas buxhetit të projektit;

Nr	Aktiviteti	Emertimi pozicionit	Sasia	Periudha	Vlera ne muaj	Pag
I	Paga	Koordinator shërbimi	1	7 Muaj /8 ore pune/dite	58000	406000
		Punonjës Social	1	7 Muaj /8 ore pune/dite	48000	336000
		Psikolog	1	5 Muaj /8 ore pune/dite	48000	240000
		Asistent për të moshuar 2	2	7 Muaj /8 ore pune/dite	40000	560000
		Kujdestare shtëpie për kujdesin afatshkurtër familjet me PAK	1	7 Muaj /8 ore pune/dite	40000	280000
Sigurime	Kontribute shoqerore dhe shendetesore		6			304776
Totali kosto stafi						2126776

2.1 Miratim Fondi sigurimin e materialeve te nevojeshme per ofrimin e sherbimit si me poshte:

Nr	Aktiviteti	Emertimi I aktivitetit	Sasia	Pag	
II	Kosto administrative	Trajnim Stafi	6	210000	
		Kancelari	1	130000	
		Sherbim transporti/ Nafte	1	150000	
	Mbeshtetje direkte ne familje	Banke ushqimesh raste emergjente	1	180000	
		ushqime te gateshme , per rastet e vecanta	1	50000	
		Materiale higjenosnitare,	1	100000	
		paisje elektro shtepiake	1	130000	
		Ndihme financiare per sherbime mjekesore	2	50000	
	Totali kosto sherbimi				1000000

- Ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi mbas miratimit nga ana e institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë.

(Emër Mbiemër)  
Përgj i Sekt. Sh.të kujdesit Shoqëror

E.Petriti

Nënshkrimi



Data

Dt 20.05.2024

**KRYETARI I BASHKISË**  
**Gëzim Topçiu**

